



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:175647
Datë: 30.03.2024
Numri i dokumentit: 05528918

KPPP.nr.1295/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbarimore të kreditorit Kompania “PANDA-T” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.S. avokate nga Prishtina, kundër debitorit “Zero Pozitiv” Sh.P.K., me seli në Prishtinë Rr. “Behar Begolli” Prishtina e Re, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.328/23 të datës 27.07.2023, të nxjerrë nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 14.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

1. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Zero Pozitiv” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.328/23 të datës 27.07.2023, të nxjerrë nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.
2. Detyrohet debitori që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë sipas prapësimit të debitorit në shumë të përgjithshme prej 208 €, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.328/23 të datës 27.07.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përmbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës nr.94, të datës 06.03.2023, me të cilin ka urdhëruar që në emër të kompensimit të borxhit për furnizimet me fishekzjarre, nga momenti i dorëzimit të propozimit për përmbarim, t'ia paguajë kreditorit borxhin në shumën prej 28,000.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe shpenzimet procedurale, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përmbaresit Privat, debitori ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se dokumenti në bazë të të cilit është marr urdhri përmbares nuk ka tipare të përmbareshmërisë, si dhe i njëjti nuk është dorëzuar në formën e përcaktuar me Ligjin për Procedurën Përmbarimore (LPP). Më tej ka theksuar se urdhri për përmbarim është nxjerrë në kundërshtim me nenet 37 dhe 40 par.1 nën par. 1.3 të LPP-së, ngase sipas këtyre neneve propozimit për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet t'i bashkangjitet dokumenti i besueshëm në origjinal apo kopja e vërtetuar sipas ligjit, ndërsa fatura nr.94 e datës 06.03.2023 nuk është paraqitur në mënyrë të tillë. Ka shtuar se dokumenti i besueshëm nuk është i përshtatshëm për përmbarim ngase nuk është caktuar koha e përmbushjes së detyrimit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si bazuar prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor i Përmbaresit Privat.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka theksuar se janë të pabaza pretendimet e debitorit se kinse fatura nuk i përmban elementet përkatëse, ngase fatura i përmban të gjitha të dhënat ashtu siç janë të parapara me nenin 27 të LPP-së, e ndër të tjera përmban edhe nënshkrimin dhe vulën e kreditorit dhe të debitorit, pra kjo fatura është e përmbareshme ngase është përpiluar siç kërkojnë dispozitat e LPP-së. Ka shtuar se qëllimi i debitorit është vetëm blerja e kohës dhe shtyrja e përmbushjes së detyrimeve të tij, ndërsa i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar dhe të vërtetohet urdhri për përmbarim i Përmbaresit Privat. I ka kërkuar shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim në shumë prej 650 Euro, bazuar në nenin 9 të Rregullores për tarifën e avokatëve të Kosovës, ku është paraparë që për përpilimin e mjeteve juridike, avokatit i takon shpërblimi i dyfishuar nga shërbimi i paraparë për parashtrësat me të cilat inicohet procedura në përputhje me nr.tarifor 6.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve të kreditorit në përgjigje në prapësim, dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentin e besueshëm faturën nr.94, të datës 06.03.2023, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nr.94, e datës 06.03.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, e njehta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin dhe vulën e debitorit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par. 1 dhe 463 par.1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Gjykata e gjeti si të bazuar kërkesën e kreditorit për pagesë të shpenzimeve sa i përket përpilimit të përgjigjes në prapësim, ndërsa lartësinë e saj gjykata e llogariti duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve

të nxjerrë nga Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 par. 2 LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, ashtu që si bazë u mor lartësia e vlerës së përmbartimit, numri i palëve të përfaqësuara, si dhe lloji i veprimit procedural për të cilin janë kërkuar shpenzimet.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 73 të LPP-së gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1295/23, me datë 14.03.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.